



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 1550 Dt. 17.07.2024

KONKURS

për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore – bachelor në vitin akademik 2024/2025

Senati i Universitetit "Isa Boletini" Mitrovicë në bazë të kompetencave sipas nenit 98 dhe 99 të statutit, në mbledhjen e mbajtur me datë 09.07.2024, ka miratuar propozimet e njëjësive akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2024/2025, dhe ka miratuar kriteret për regjistrim në studimet themelore bachelor. Propozimet e numrit të studentëve pas miratimit nga senati gjithashtu janë aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me shkresën nr. prot. 2024 datë 17.07.2024.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë, në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik **2024/2025**, do të regjistrojë **840** studentë të rregullt.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI, UIBM do të regjistrojë deri në 12%, përkatësisht deri **99** studentë të rregullt nga komunitetet jo-shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komunitetet jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
3. Në UIBM, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT, mund të pranohen edhe kandidatët nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvegja, Maqedonia dhe Shqipëria. Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen nga këto vende do të jetë 5% e numrit të përcaktuar si në paragrafin 1 të pikës I, përkatësisht deri **43** studentë. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshtuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova. Kandidatët nga Shqipëria, mbështetur në marrëveshjen e datës 20.6.2022 ndërmjet dy ministrive respektive, mund të regjistrohen edhe në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve.
4. Përjashtimisht kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2 dhe 3, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
5. Mbi bazë të konsideratave humane, UIBM rezervon të drejtën e pranimi të kandidatëve me nevoja të veçanta të cilët statusin e tyre duhet ta dëshmojnë me certifikata përkatëse, të lëshuara nga institucionet gjegjëse.
6. Universiteti nuk do të ju mundësoj lehtësira për pranim nëse njeri prej kandidatëve binjak nuk pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
7. Të drejtë pranimi në UIBM kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm e kanë përfunduar në njërin prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe që e kanë diplomën për shkollimin e kryer.

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

8. Në UIBM mund të pranohen edhe studentët nga shtetet e tjera, në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
9. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe që nuk kanë nënshtetësi Kosovare.
10. Dëshmia - Vendimi për: Njohja e diplomës - dëftesës; Barasvlerësimi i diplomës; Sukses i përgjithshëm gjatë viteve të shkollimit dhe barasvlerësimi i notave dhe Barasvlerësimi i Provimit të Maturës dhe përcaktimi se kandidati i plotëson kushtet për konkurrim në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës, lëshohet nga MASHTI - NARIC Kosova (për kandidatët nga Republika e Shqipërisë). Të njëjtën procedurë e ndjekin edhe kandidatët tjerë jo-kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe që nuk kanë nënshtetësi Kosovare, në këto raste, barasvlera e notave mund të bëhet edhe nga Zyra për sigurimin e cilësisë e UIBM.
11. UIBM do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram.
12. Njësitë akademike përkatëse të UIBM, me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
13. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale: *"çdo kandidatë që mbi bazën e deklaramit të rrejshëm, apo dokumentacionit të falsifikuar ka arritur të pranohet në mënyrë të padrejtë në UIBM, do të përjashtohet në mënyrë automatike nga UIBM, në momentin e vërtetimit të një fakti të tillë"*.
14. **Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të UIBM nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UIBM pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.**
15. **Kandidatët për pranim si student të UIBM-it në vitin akademik 2024/25 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet apo program.**

II. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë në fakultetin përkatës më së largu dy (2) ditë pune pas publikimit të rezultateve. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës, vendimi përfundimtar rreth ankesës merret brenda tri (3) ditëve të punës nga shpallja e rezultateve preliminare.

III. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet e poshtëshënuar:

Fakulteti i Gjeoshkencave, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, do të bëhet sipas kriterëve në vijim:

a. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

1. Sukses i shkollës së mesme deri në 30 pikë;

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

2. Suksesi në provimin pranues deri në 70 pikë.

b. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

1. Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
2. Suksesi në maturë deri në 30 pikë;
3. Suksesi në provimin e maturës nga lëndët me përparësi për regjistrim në Fakultet deri në 40 pikë.

Lëndët me përparësi për regjistrim në Fakultet janë të shënuara në pjesën e konkursit ku bëhet fjalë për secilin prej këtyre fakulteteve.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet e poshtëshënuara:

Fakulteti Juridik, dhe Fakulteti Ekonomik do të bëhet sipas kritereve si në vijim:

a. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

1. Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
2. Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.

b. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

1. Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
2. Suksesi në maturë deri në 30 pikë; dhe
3. Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.

3. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
4. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
5. Përjashtimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 3 dhe 4 të pikës III, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kritereve të përcaktuara si në paragrafin 2 dhe 3 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
6. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues më së shumti në tri lëndë mësimore, të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
7. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm nga shkolla e mesme. Nëse edhe pas kësaj do të kemi të njëjtin rezultat, merret suksesi nga lëndët e ngushta profesionale. Nëse rezultatet e numrit të barabartë të pikëve përsëritet, atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore. Në rastin e fakulteteve në të cilat organizohet provimi pranues përparësia e studentëve fillon nga numri i pikëve të fituara në provimin pranues, pastaj suksesi nga shkolla e mesme dhe në fund përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore. Nëse edhe pas këtij kriteri numri i pikëve mbetet i barabartë atëherë zgjedhjen e kandidatëve do të bëjë komisioni përkatës i fakultetit.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

8. Fakultetet janë të obliguara që tërë listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t’ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e Universitetit.
9. Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

IV. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online <https://www.umib.net/> në linkun APLIKO, hapet prej datës **18.07.2024 deri më datë 29.07.2024 në ora 16.00.**
2. Aplikimi online do të funksionalizohet prej ditës së parë të konkursit, përkatësisht prej datës **18.07.2024, nga ora 10:00.**
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik, pas aplikimit online, do të bëhet prej datës **18.07.2024 deri më datë 29.07.2024 çdo dite përveç të dielave.** Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës.
4. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t’i noterizojnë (vula noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t’i tërheqin deri në diplomim apo ç’regjistrim nga fakulteti.
5. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim online dhe fizik është si në vijim:**
 - a) *Ekstrakti i lindjes (origjinal), jo më i vjetër se 6 muaj;*
 - b) *Kopja e letërnjoftimit;*
 - c) *Dëftesa e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal, të noterizuara ose duplikat)*
 - d) *Diploma e kryerjes së shkollës së mesme (origjinal, të noterizuar ose duplikat)*
 - e) *Dëftesa e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal, të noterizuar ose duplikat)*
 - f) **Vërtetimi mbi pikët e fituara në provimin e maturës për lëndët mësimore (vetëm kandidatët për fakultetet: Fakulteti i Gjeoshkencave, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike);**
 - g) **Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegza (linku) për konkurrim online përmes internetit është: <https://www.umib.net/> në linkun APLIKO;**
 - h) *Dëshmia mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit-Lista e institucioneve parauniversitare të licencuara në vend, sigurohet në MASHTI nga Administrata Qendrore e UIBM (nëse kandidatët nuk mund ta sigurojnë këtë dëshmi gjatë periudhës së aplikimit online, atëherë dëshmia mund të dorëzohet me rastin e aplikimit fizik).*
6. **Me rastin e aplikimit në datat e caktuara si në pikën 3 të kapitullit IV, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e kërkuara si në pikën 5 të këtij kapitulli, t’i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve.**
7. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb-faqet e këtyre fakulteteve.
8. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të shpallura në vijim:



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Provimet pranuese do të mbahen sipas këtij orari:

Më 30.07.2024, në orën 10:00 Fakulteti Juridik.

Me 30.07. 2024 në ora 10 Fakulteti Ekonomik.

Më 30.07. 2024, në orën 10:00, në këto fakultete: Fakulteti i Gjeoshkencave; Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike. (vetëm kandidatët me sistem të vjetër që nuk kanë provim të maturës).

9. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të kenë me vete letërnjoftimin ose pasaportën. Kandidatët nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues pa dokument identifikimi. Kandidatët të cilët nuk paraqiten në kohën e caktuar për mbajtjen e provimit pranues, sipas orarit të shpallur, nuk do të lejohen të marrin pjesë në provim. Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!
10. Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues do të bëhet, me datë 30.07.2024 në fakultetet përkatëse si dhe në ueb-faqen e Universitetit.
11. Afati për ankesat nga momenti i shpalljes të rezultateve preliminare deri më 01.08.2024, ora 16:00.
12. Shpallja e rezultateve përfundimtare pas shqyrtimit të ankesave përkatësisht me datë 02.08.2024.
13. Në programet e studimit ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkursi plotësues.
14. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.umib.net
15. Regjistrimi, fotografimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet prej 04.09.2024 deri më 09.09.2024, prej orës 9:00 – 15:00.
16. Kandidatët të cilët nuk kanë arritur të regjistrohen brenda afatit të përcaktuar me sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më 04.10.2024 në ora 15:00. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen për shkak të mbylljes së sistemit për Menaxhimin e Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL) prandaj luten që t'i përmbahen afatit të lartshënuar.
17. Në qoftë se kandidati i pranuar, në afatin e caktuar nuk përfillë të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit.
18. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
 1. Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit dhe fotografimit.
 2. Letërnjoftimin.
 3. Bazuar në udhëzimin administrativ nr 09/2021 studentët që regjistrojnë semestrin për herë të parë është pa pagesë.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Numri i studentëve për regjistrim sipas fakulteteve dhe programeve të studimit

Fakulteti- Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, Maqedonia dhe Shqipëria	Gjithsej
Fakulteti i Gjeoshkencave	100	14	6	120
Gjeologji	50	7	3	60
Xehetari	50	7	3	60

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës, suksesi i të cilave do të merret parasysh për pranim, janë: Matematika, Fizika dhe Kimia.

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa provim të maturës, provimi pranues do të mbahet nga lënda: Matematikë.

Fakulteti- Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, Maqedonia dhe Shqipëria	Gjithsej
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	166	24	10	200
Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	83	12	5	100
Teknologji: Specializimi Inxhinieri Kimike Specializimi: Inxhinieri mjedisore	83	12	5	100

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës, suksesi i të cilave do të merret parasysh për pranim, janë:

Programi Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore: Matematika, Biologjia dhe Kimia.

Programi Teknologji: Me specializime: Inxhinieri kimike; Inxhinieri e mjedisit: Matematika, Fizika dhe Kimia.

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa provim të maturës, provimi pranues do të mbahet nga lëndët:

Programi Inxhinieri edhe Teknologji Ushqimore: Biologjia dhe Matematika.

Programi Teknologji: Me specializime: Inxhinieri kimike; Inxhinieri e mjedisit: Matematika.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Fakulteti- Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, Maqedonia dhe Shqipëria	Gjithsej
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	315	45	20	380
Inxhinieri Mekanike	58	8	4	70
Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	133	19	8	160
Inxhinieri Ekonomike	124	18	8	150

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës, suksesi i të cilave do të merret parasysh për pranim, janë: Matematika, Fizika dhe Informatika.

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa provim të maturës, provimi pranues do të mbahet nga lënda: Matematikë

Fakulteti- Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, Maqedonia dhe Shqipëria	Gjithsej
Fakulteti Juridik	67	9	4	80
Juridik				

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Gjuhë shqipe.

Fakulteti- Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, Maqedonia dhe Shqipëria	Gjithsej
Fakulteti Ekonomik	50	7	3	60
Biznes dhe menaxhment specializimi – Banka Financa dhe kontabilitet				
Menaxhment dhe ndërmarrësi	50	7	3	60

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi dhe Matematikë.

